



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Data:	05.04.2018
Referencë:	
Për:	Kryetarin e Komunës z. Imri Ahmeti
Nga:	Ilir Tasholli - Drejtor i DSHP-së
Lënda:	Raporti i muajit Mars 2018

Në bazë të përgjegjësisve dhe kompetencave gjatë muajit Mars 2018, DSHP-ja ka kryer punë dhe aktivitetet e veçanta që janë kërkuar sipas dinamikës së zhvilluar dhe kërkesave të parashtruara nga ana e qytetarëve dhe nga ana e institucioneve. Kërkesat janë të paraqitura në mënyrë tabelore:

Pasqyra e lëndëve (kërkesave) për muajin Mars				
Nr. i kërkesave të pranuar	Të zgjidhura	Të refuzuara	Në kompetencë	Në procedurë
35	17		3	15

- Janë dhënë Vendime, përgjigje, pëlqime, njoftime të ndryshme sipas kërkesave të qytetarëve dhe institucioneve.
- Mbikëqyrja e kompanisë “Algemi” e cila mirëmban dhe menaxhon me tregjet
- Mbikëqyrja e rrugëve dhe e trotuareve në qytetin e Lipjanit si dhe rrugëve lokale.
- Mbikëqyrja e kompanisë KRM “Pastrimi” NjO Lipjan për mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror Loti 1, mbikëqyrja kompanisë NTSH Durimi Prishtinë Loti 2, dhe mbikëqyrja e kompanisë EL BAU shpk Gjilan Loti i 3, ku pas të reshurave të borës në këtë muaj janë pastruar të gjitha rrugët e qytetit si dhe rrugët në fshatra të komunës nga kompanitë të cilat janë kontraktuar, gjithashtu edhe kompania Eing Com ka pastruar shtigjet e këmbësorëve në parqe dhe hapësirat e parkingjeve nga bora dhe akulli.
- Mbikëqyrja e kompanisë “Eing Com” e cila bënë mirëmbajtjen e parqeve, parkingjeve dhe hapësirave tjera në qytetin e Lipjanit.
- Është bërë barazimi i të hyrave me kompaninë Algemi, dhe barazimi i të hyrave nga hapësirat publike.
- Janë bërë kërkesa DBF për zotim të mjeteve për projektet kapitale si dhe kërkesa tjera nga mallra dhe shërbime
- Janë bërë kërkesa KEDS-it njësia në Lipjan lidhur me rrjetin e ndriçimit publik në Komunën e Lipjanit
- Janë bërë zhbllokime të rrjetit të kanalizimeve me kompaninë e ujësjellësit KUR Prishtina në këto lokacione: Babush i Muhaxherëve, Gadime e Ultë, Gadime e Epërme, Qylagë, Vërshevc, Vrellë e Goleshit dhe Shalë, në disa lokacione është zhbllokuar në disa lokacione tjera duhet të intervenohet përsëri.
- Kërkesë Drejtorisë së Inspektoratit për inspektim të bizneseve për shfrytëzim të hapësirës publike

- Vizitë në teren për inqizimin e rrugëve për mbushjen e gropave me asfalt në tërë komunën si dhe për shenjzim horizontal dhe vertikal në afërsi të shkollave.
- Platesimi i formularit identifikimi - vlerësimi dhe monitorimi i rrezikut -2017
- Është bërë plotësimi i planit të integritetit nga fusha e DSHP-së
- Takim me asociacionin e komunave dhe GIZ-in për fushën e menaxhimit të mbeturinave.
- Pjesëmarrja në hapje dhe vlerësim të ofertave tenderuese në Drejtoratin e Prokurimit
- Kërkesë Ministrisë së Infratrakturës – Departamentit për Transportin Rrugor për vazhdim të punimeve në rrugën Lipjan Magurë si dhe fillimi e procedurave për asfaltimin e rrugës Lipjan deri te udhëkryqi Janjevë.
- Kërkesë Drejtoratit për Shërbime Publike në Prishtinë për marrëveshja ndërkomunale në mes të Komunës së Prishtinës dhe Komunës së Lipjanit për ndaljen dhe marrjen e udhëtarëve të rrethi (Flamuri)
- Është bërë kërkesa Drejtorisë së Prokurimit për inicim të procedurave: asfaltimi i rrugës Babush – Cërnillë, asfaltimi i rrugës Luftëtarët e Lirisë Babush, asfaltimi i rr. Dobrajë e Vogël – Magurë, asfaltimi i rrugës Ribar i Madh – Torinë, hapja dhe zgjerimi i lumenjve në fshatrat e komunës, asfaltimi i rrugës Torinë- Ribar i Vogël, ndërtimi i murit mbrojtës në fshatin Gadime e Epërme, renovimi i lapidarit të Kombit Xhavit Kozhani.
- Janë bërë kërkesa Shërbimit Pronsoro Juridik dhe DGJK për definim të pronës dhe caktimin e pikave gjeodezike për: asfaltimin e rrugicave në fshatin Konjuh, asfaltimi i disa rrugicave në Janjevë
- Pjesëmarrja në komision për plotësimin dhe ndryshimin për rregulloren për taksat komunale.
- Menaxherët e projekteve së bashku me kompaninë projektuese janë duke asistuar në përgatitjen e projekteve detale sipas prioriteteve.
- Janë përgatitë paramasa dhe paralogari.
- Mbikëqyrjet e punimeve të projekteve:
- Ndërtimi i sheshit Adem Jashari punimet janë duke vazhduar dhe janë në përfundim e sipër.
- Ndërtimi i fushave të vogla sportive në disa fshatra të komunës së Lipjanit, punimet janë duke vazhduar, projekt dy vjeçar.
- Asfaltimi i rrugës Shalë, është bërë asfaltimi dhe pritjet pranimit teknik.
- Asfaltimi i rrugëve në fshatin Rubovc punimet kanë vazhduar me asfaltimin e rrugëve të mbetura, po vazhdohet me bankina – projekt dy vjeçar.
- Asfaltimi i rrugëve në fshatin Kraishtë është bërë asfaltimi – projekt dy vjeçar.
- Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gadime e Epërme, punimet janë ndërprerë për shkak të kushteve atmosferike.
- Ndërtimi i zonës Industriale Qylagë, punimet janë ndërprerë për shkak të kushteve atmosferike.
- Asfaltimi i rrugicave në fshatin Glllogovc është bërë asfaltimi, po vazhdohet me ndërtimin e urës dhe punë tjera, punimet janë ndërprerë për shkak të kushteve atmosferike.
- Ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik në Glllogovc, punimet janë duke u menaxhuar nga komisioni komunal.
- Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dobrajë e Madhe punimet janë ndërprerë për shkak të kushteve atmosferike – projekt dy vjeçar.
- Asfaltimi i rrugës Topliqan – Vojnovc punimet janë ndërprerë – projekt tre vjeçar.
- Punë tjera në teren sipas kërkesave të ndryshme të qytetarëve dhe institucioneve.

Janë kryer edhe punë të tjera sipas nevojës dhe kërkesës së DSHP-së

Pasqyra e aktiviteteve të DSHP-së		
Nr	Lloji i aktivitetit	Nr.
1	Kërkesa, njoftime, pëlqime, përgjigje si dhe shkresa te ndryshme organeve brenda komunës dhe institucioneve tjera	20
2	Takime me përfaqësuesit e fshatrave	0
3	Përgatitja e paramasave dhe paralogarive	4
4	Takime zyrtare në Ministrinë e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit	0
5	Takime zyrtare në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	0
6	Takime zyrtare në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal	0
7	Vizita në terren	49
8	Pjesëmarrja në konferenca dhe trajnime të ndryshme	1
9	Pjesëmarrja në hapjen dhe vlerësimin e tenderëve	0